

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja e çështjes Anita Krasniqi Prenaj me sekretaren juridike Fexherie Tashevci, në çështjen penale kundër të akuzuarve L.S.dhe A.L., për shkak se secili veç e veç kanë kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.6352/17, të datës 13.11.2017, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datë 13.02.2018, në prezencën e Prokurorit të shtetit Enver Krasniqi, të akuzuarve L.S.dhe A.L., në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

L.S., nga i ati A. dhe e ëma Sh., e gjinisë G., i lindur më datë ..., me numër personal ..., me vendbanim në fshatin M., Komuna O., i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

A.L., nga i ati D. dhe e ëma G., e gjinisë K., i lindur më datë ..., me numër personal ..., me vendbanim në P., Lagja M., rr. "I.K.", nr. ..., i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse:

I. I pandehuri L.S.

Më datë 20.10.2017, rreth orës 14:20, në P., rr. "I.K.", në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, pa leje ka poseduar pistoletën e tipit "TT", me numër serik MB7H-109310 dhe një karikatorë me 8 (tetë) fishek, të cilat janë gjetur dhe konfiskuar nga Policia e Kosovës.

- **Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.**

II. I pandehuri A.L. (Krasniqi)

Më kohe dhe vend si në dispozitivin I të kësaj aktakuzë, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, pa leje ka poseduar një Sprej lotësjellës dhe një thikë, të cilat janë gjetur dhe konfiskuar nga Policia e Kosovës.

- **Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata konform nenit: 7, 17, 21, 41, 49, 51, 52, 74 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të akuzuarve ju shqipton:

DËNIM ME KUSHT

I. Të akuzuarit L.S., i shqipton dënim me kusht me të cilin i vërteton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk do të kryej vepër tjetër penale në afat prej 1 (një) vit.

a) Në dënimin e shqiptuar do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 20.10.2017 deri më dt. 19.11.2017.

II. Të akuzuarit A.L., i shqipton dënim me kusht me të cilin i vërteton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk do të kryej vepër tjetër penale në afat prej 1 (një) vit.

III. Kundër të akuzuarve shqiptohet dënim plotësues – Marrja e sendit, të konfiskohen revolja e tipit “TT”, me numër serik MB7H-109310, një karikatorë me 8 (tetë) fishek, spreji lotsjellës dhe një thikë, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohen të akuzuarit që në mënyrë solidare të paguajnë shpenzimet e procedurës aq sa do të bëhen sipas llogarisë së kësaj gjykate dhe paushallin gjyqësor secili veç e veç në shumë prej 20€, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën PP.II.nr.6352/17, të datës 13.11.2017, ka akuzuar L.S.dhe A.L., se secili veç e veç kanë kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata me datë 13.02.2018, mbajti shqyrtimin fillestar, ku morën pjesë prokurori i shtetit Enver Krasniqi, të akuzuarit L.S.dhe A.L..

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit Enver Krasniqi, i akuzuari L.S.ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe se e ndjenë veten fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari A.L., ka deklaruar se ka kuptuar aktakuzën dhe se e ndjenë veten fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet.

Prokurori i shtetit Enver Krasniqi, u pajtua me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, pasi që ka vlerësuar se një pranim i tillë është në përputhje me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si ato të natyrës personale dhe materiale, gjykatës i propozon që ta aprovoj pranimin e fajësisë.

Meqenëse pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve ishte i vullnetshëm dhe i plotë, të vetëdijshëm për përparësitë dhe pasojat e një pranimi të tillë, gjykata mori aktvendim me të cilin e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve pasi që vlerësoje se ky pranim ishte në përputhje të plotë edhe me provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës, e që të gjitha këto në mënyrë të plotë dhe të argumentuar e vërtetojnë faktin se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata nuk administroi provat por vazhdoi me matjen e dënimit.

Gjatë matjes së dënimit, gjykata i vlerësoj të gjitha rrethanat lehtësues dhe rëndues të cilat ndikojnë në llojin dhe në lartësinë e dënimit konform nenit 73 të KPRK-së. Andaj gjykata si rrethanë lehtësues për të akuzuarin L.S.mori faktin se ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën u shpall fajtor, është penduar thellë, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale edhe për të akuzuarin A.L. mori faktin se ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën u shpall fajtor, është penduar thellë, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale. Andaj, të akuzuarve ju shqiptoi dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit, me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e tyre, si dhe do të ndikojë tek të tjerët që mos të kryejnë vepra penale çka është edhe qëllimi i shqiptimit të dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi obligimin e të akuzuarve që ti paguajnë paushallin gjyqësor u mor konform nenit 456 të KPP-së, ndërsa lartësia e paushallit u caktua duke pasur parasysh gjendjen financiare të akuzuarve.

Vendimin mbi udhëzimin e të dëmtuarve për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil u mor konform nenit 463 par. 2 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
P.nr.5197/17 me datë 13.12.2018

Sekretarja Juridike
Fexhrie Tashevc

G j y q t a r j a
Anita Krasniqi Prenaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.

Pas kësaj, gjykata të njëjtën ditë mori:

NË EMËR TË POPULLIT

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit L.S.dhe A.L., me të dhënat si në procesverbal.

JANË FAJTOR

Sepse:

I. I pandehuri L.S.

Më datë 20.10.2017, rreth orës 14:20, në P., rr. "I.K.", në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, pa leje ka poseduar pistoletën e tipit "TT", me numër serik MB7H-109310 dhe një karikatorë me 8 (tetë) fishek, të cilat janë gjetur dhe konfiskuar nga Policia e Kosovës.

- **Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.**

II. I pandehuri A.L. (K.)

Më kohe dhe vend si në dispozitivin I të kësaj aktakuzë, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, pa leje ka poseduar një Sprej lotësjellës dhe një thikë, të cilat janë gjetur dhe konfiskuar nga Policia e Kosovës.

- **Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata konform nenit: 7, 17, 21, 41, 49, 51, 52, 74 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të akuzuarve ju shqipton:

DËNIM ME KUSHT

I. Të akuzuarit L.S., i shqipton dënim me kusht me të cilin i vërteton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk do të kryej vepër tjetër penale në afat prej 1 (një) vit.

a) Në dënimin e shqiptuar do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 20.10.2017 deri më dt. 19.11.2017.

II. Të akuzuarit A.L., i shqipton dënim me kusht me të cilin i vërteton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk do të kryej vepër tjetër penale në afat prej 1 (një) vit.

III. Kundër të akuzuarve shqiptohet dënim plotësues – Marrja e sendit, të konfiskohen revolja e tipit "TT", me numër serik MB7H-109310, një karikatorë me 8 (tetë) fishek, spreji lotsjellës dhe një thikë, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohen të akuzuarit që në mënyrë solidare të paguajnë shpenzimet e procedurës aq sa do të bëhen sipas llogarisë së kësaj gjykate dhe paushallin gjyqësor secili veç e veç në shumë prej 20€, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Vërtetojnë

Procesmbajtësja

Fexherie Tashevc

Gjyqtarja

Anita Krasniqi Prenaj